

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE
“Markej 21” Sh.p.k.**

Sot, më datë 18/08/2021 (dymijë e njëzetenjë), dy ortakët themelues:

z. Mauro Zaçe, shtetas shqiptar, i biri i Ivanit, i lindur më 16.10.1997, banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nga karta e identitetit me nr.personal J71016053T.

z. Kejdi Vila, shtetas shqiptar, i biri i Dritanit, i lindur më 21.10.1997 në Gramsh, person madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nga karta e identitetit me nr.personal J71021087F.

Nënskruajnë këtë Akt Themelimi, në të cilësinë e Ortakëve Themelues dhe shprehin vullnetin të themelojnë shoqërinë tregtare “Markej 21” Sh.p.k., me kushtet si më poshtë:

**NENI 1
Statusi Juridik**

Shoqëria Tregtare “Markej 21” Sh.p.k është formuar si Shoqëri tregtare sipas ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, (në vazhdim referuar si “Shoqëria”). Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.
Ajo ka formën e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar.

**NENI 2
Emri i shoqërisë**

Emri i shoqërisë do të jetë “Markej 21” SHPK (në vijim referuar si “Shoqëria”).

**NENI 3
Objekti i veprimtarisë**

Objekti i Veprimtarise së Shoqërisë do të jetë, por duke mos u kufizuar në:

- Tregëti të artikujve të ndryshëm të veshjeve, këpucë, aksesorëve, me shumicë dhe pakicë, import, eksport etj..
- Gjithashtu, shoqëria mund të kryejë cdo aktivitet tjeter plotësues dhe ndihmës që ka si qëllim ofrimin e cdo aktiviteti tjeter, në rast se rezultojnë të dobishme dhe/ose të nevojshme për përmbrushjen e objektit kryesor, si dhe çdo aktivitet tjeter që konsiderohet fitimprurës dhe në interes të shoqërisë.



NENI 4
Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga “Abdyl Frashëri”, Vesa Center, Kati 1, Tiranë, Shqipëri.

Me vendim të ortakëve mund të hapen ose të mbyllen në Shqipëri ose jashtë, njësi dytësore, degë dhe filiale.

NENI 5
Kapitali i Shoqërisë

Kapitali fillestar i investuar nga ortakët, përbën bazën e krijimit të fondit themelor të mjeteve të xhiros.

Kapitali i shoqerisë është në vlerën 100 (një qind) leke, i ndarë në 2 (dy) kuota.

Kuotat do të zotërohen nga ortakët sipas ndarjes së mëposhtme:

z. Mauro Zaçe, zotërues i një kuote të kapitalit themeltar, që përbën 51 % të kapitalit të shoqërisë, në vlerën 51 lekë.

z. Kejdi Vila, zotërues i një kuote të kapitalit themeltar, që përbën 49 % të kapitalit të shoqërisë, në vlerën 49 lekë.

Kontributi i kapitalit është i gjithi në para dhe i shlyer plotësisht.

NENI 6
Kohëzgjatja e Shoqërisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Regjistrin e Biznesit. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 7
Organet Drejtuese

Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqerisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve — organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori — organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.



Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cili mund të zgjidhet për një afat 5 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i Shoqërisë "Markej 21" Sh.p.k, është **Z. Mauro Zaçe**, shtetas shqiptar, i biri i Ivanit, i datëlindjes 16.10.1997, banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nga karta e identitetit me nr.personal J71016053T, i cili zgjidhet për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripërtëritje.

Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushton të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 8
Ligji i aplikueshëm

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga Ortakët Themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.


NENI 9
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe që mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me Shoqërinë, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë.

NENI 10
Dispozitat përfundimtare

Akti Themelimi përpilohet në 3 (tre) kopje në gjuhen shqip, dhe nënshkruhet nga ortakët themelues.

ORTAKËT THEMELUES

Mauro ZAÇE


Kejdi VILA
